



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2662/6 prot.

Datë 21.10.2025

V E N D I M
Nr. 1490/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 21.10.2025 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik Ervin Luzi në procedurën e prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-58861-08-22-2025, me objekt: “Blerje materiale elektrike per rehabilitimin e ndricimit te aksit rrugor Shkoder - Mes”, me fond limit 8,164,336.12(Tetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e treqind e tridhjetë e gjashtë pikë dymbëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 04.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërrmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike, Shkodër
- Ankimues:** Operatori ekonomik Ervin Luzi me Nipt K71707007Q dhe adresë: Lagjja Katund i Ri, Rruga Ali Pashe Gucia, Godina nr.5, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Ndërrmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike
Lagjja Tre Heronjte, Shkodër
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për

miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3(tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 25.08.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit E Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-58861-08-22-2025, me objekt: “Blerje materiale elektrike për rehabilitimin e ndricimit të aksit rrugor Shkoder - Mes”, me fond limit 8,164,336.12(Tetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e treqind e tridhjetë e gjashtë pikë dymbëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 04.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike..

II.2. Në datën 04.09.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 24.09.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. ERVIN LUZI PF	5,860,000 lekë	skualifikuar
2. "HEST" SHPK	6,850,600 lekë	s'kualifikuar
3. "ITE GROUP" SHPK	4,989,900 lekë	kualifikuar
4. "PREKA" SHPK	7,442,400 lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 16.09.2025 operatori ekonomik "ZEQIRI" SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

"Nuk ka paraqitur furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit ne ndriçues rrugor, shtylla që janë zerat me peshë me të madhe specifike ne preventive.

Autorizimi i distributorit nga ABIESSE është për AK Bashkia Shkodër dhe jo për NSHPP. Autorizimet e prodhuesit nuk janë të perkthyer nga perkthyes të çertifikuar dhe të noterizuara.

Nuk keni paraqitur katalog të prodhuesit pasi kataloget e paraqitur janë marre me foto nga WEB nuk janë perkthyer e noterizuar".

II.5. Në datën 25.09.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik "Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraprak" për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.6. Në datën 29.09.2025 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa e operatorit ekonomik Ervin Luzi me numër ankimimi elektronik elektronik A/2025/5863, datë 28.09.2025 dhe me Nr. 2662/2025 Prot., datë 29.09.2025 ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike me pretendimet si vijon:

"Kemi marrë pjesë, duke paraqitur ofertën tonë, në procedurën e prokurimit me objekt ?Blerje materiale elektrike per reabilitimin e ndricimit te aksit rrugor Shkoder ? Mes?, me fond limit 8,164,336.12 lekë pa TVSH, me nr. REF-58861-08-22-2025, zhvilluar në datën 04.09.2025, nga autoriteti kontraktor Ndërrmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike.

Në datën 17.09.2025, jemi njohur me vlerësimin dhe klasifikimin e ofertave. Oferta e paraqitur nga ana jonë është skualifikuar, për arsyet e mëposhtme:

-Nuk ka paraqitur furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit ne ndriçues rrugor, shtylla që janë zerat me peshë me të madhe specifike ne preventive. Autorizimi i distributorit nga ABIESSE është për AK Bashkia Shkodër dhe jo për NSHPP. Autorizimet e prodhuesit

nuk janë të perkthyer nga perkthyes të çertifikuar dhe të noterizuara. Nuk keni paraqitur katalog të prodhuesit pasi kataloget e paraqitur janë marre me foto nga WEB nuk janë perkthyer e noterizuar.

Duke qenë se nuk jemi dakord me arsyet e skualifikimit të ofertës tonë, paraqesim këtë ankesë

1. Lidhur me arsyen e skualifikimit ?-Nuk ka paraqitur furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit ne ndriçues rrugor, shtylla që janë zerrat me peshë me të madhe specifike ne preventive.?

Në dokumentet e tenderit, autoriteti kontraktor ka kërkuar: ?2.3.1. Furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit në një vlerë jo më të vogël se 20 % fondit limit prej 1,632,867 (një milion e gjashtëqind e tridhjetë e dy mijë e teteqind e gjashtedhjetë e shtate) lekë, të ekzekutuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Në përmbushje të këtij kriteri, në kemi paraqitur 18 fatura tatimore të fiskalizuar shitje, të cilat vërtetojnë se ne kemi shitur mallra elektrike, përfshirë edhe ndricues rrugor.

Sikurse përcaktohet në kriterin e vendosur nga vetë AK në DST, apo dhe në rregullat e prokurimit publik, për të përmbushur kriterin 2.3.1, nuk kemi patur detyrimin të paraqesim furnizime të njëjta, por të ngjashme. Theksojmë se më furnizime të ngjashme konsiderojmë furnizime me material të së njëjtës kategorie mallrash, pra materiale elektrike.

Në rastin tonë, faturat e paraqitura provojnë se ne kemi furnizuar me materiale të ngjashme elektrike, si dhe në shumë raste të njëjta. Akoma më tej, në faturën nr. 197/2023,(file i titulluar fatura 2.pdf), ne kemi furnizuar me ndricues rrugor.

Theksojmë se me këtë arsye skualifikimi, AK jo vetëm nuk ka vlerësuar me frymën e ligjit në tërësi, por ka vlerësuar në kundërshtim edhe me përcaktimet në nenin 40, pika 4, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 ?Për miratimin e rregullave të prokurimit publik? i ndryshuar.

Sa më sipër, kjo arsye skualifikimi nuk qëndron.

2. Lidhur me arsyet e skualifikimit ?Autorizimi i distributorit nga ABIESSE është për AK Bashkia Shkodër dhe jo për NSHPP. Autorizimet e prodhuesit nuk janë të perkthyer nga perkthyes të çertifikuar dhe të noterizuara?

Në dokumentet e tenderit, autoriteti kontraktor ka kërkuar: ?2.3.4. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin e kompanisë prodhuese/distributorit për shitje. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/ve si: telefon, fax, e-mail, ëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.?

Në përmbushje të këtij kriteri ne kemi paraqitur autorizim nga distributori A Bi Esse me datë 02.09.2025, me anë të së cilës ky i fundit na autorizon që të ofrojmë në këtë procedurë prokurimi materialet e markave DISANO, BRUNO BALDASSARI, LEGRAND, SCHNEIDER ELECTRIC dhe GEWISS.

Përsa i takon arsyet Autorizimi i distributorit nga ABIESSE është për AK Bashkia Shkodër dhe jo për NSHPP, Ju sjellim në vëmendje se AK është në varësi të Bashkisë Shkodër dhe si i tillë është shënuar Bashkia Shkodër si autoritet kontraktor. Gjithësesi edhe nëse do e konsideronim si një lapsus, në autorizimin e distributorit janë cituar objekti i prokurimit që përputhet plotësisht, si dhe numri i referencës së procedurës së prokurimit që është unik dhe nuk lë vend për ekuivok.

Pra, në këtë autorizim distributori është mëse e qartë se për këtë procedurë prokurimi është leshuar ky autorizim.

Ndërsa përsa i takon arsyet ?Autorizimet e prodhuesit nuk janë të perkthyer nga perkthyes të çertifikuar dhe të noterizuara?, Ju sjellim në vëmendje se ne kemi paraqitur vetëm një autorizim distributor në gjyhen shqipe, duke e përmbushur këtë kriter vetëm me këtë dokument. Autorizimet e tjera të prodhuesve ndaj distributorit i kemi paraqitur me iniciativën

tonë, për t'i krijuar një panoramë më të qartë autoritetit kontraktor mbi seriozitetin dhe kapacitetet tona, si dhe për të bindur AK se distributori jonë është i autorizuar nga prodhuesit për produktet që tregton, për të cilat na autorizon dhe ne për ti ofruar në këtë procedurë prokurimi

Sa më sipër, këto arsye skualifikimi nuk qëndrojnë.

3.Lidhur me arsyen e skualifikimit ?Nuk keni paraqitur katalog të prodhuesit pasi kataloget e paraqitur janë marre me foto nga WEB nuk janë perkthyer e noterizuar?

Në dokumentet e tenderit, autoriteti kontraktor ka kërkuar: ?2.3.3 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve për mallin objekt prokurimi, ne të cilet të tregohen dhe të specifikohen qarte materiali që do të ofrohet.Pjesët e katalogut të prodhuesit ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve duhet të jenë të perkthyera në shqip.

Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qarte që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.?

2.3.5. Ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentin e titulluar ?Ofertë Teknike? i paraqitur nga Autoriteti Kontraktor në formën e një table (pjesë e dokumentacionit të specifikimeve teknike), kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga Ofertuesi për të gjithë artikujt e Listës.

Në plotësim të kësaj kerkese Dokumenti ?Ofertë teknike? duhet të përmbajë të dhënat si mëposhtë: Referenca në katalogje, kodi I produktit (në rast se mungon kodi i produktit të plotësohet nr I faqes), duke treguar kodin ose numrin e faqes së katalogut në katalogun perkates ku autoritetit kontraktor mund të gjejë specifikimet e plota teknike të ofertuesit të cilat duhet të përputhen me specifikimet e AK.

- Në fushën ?SHENIM? OE mund të shkruaj sqarime të ndryshme në lidhje me produktet e ofruara.

Shënim: Mosplotësimi i ofertes teknike për të gjithë zerat e kërkuar është kusht për skualifikim Hartimi dhe plotësimi i kërkesave të Ofertës Teknike më sipër, kërkohet që të kryhet nga vete ofertuesi, për të vlerësuar në këtë mënyrë nëse, produktet që ofrohen të jenë në përputhje me ato që kerkohen prej Autoritetit Kontraktor në DST.

Sikurse ka përcaktuar edhe vetë AK në kriterin e vendosur, apo sikurse përcaktohet në pikën 6 të nenit 40, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 ?Për miratimin e rregullave të prokurimit publik? i ndryshuar, katalogët ose fragmentet e katalogëve të prodhuesve kërkohen që të krahasohet pajtueshmëria e produkteve të ofruara nga operatori ekonomik ofertues me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara.

Theksojmë se tashmë ndodhemi në vitin 2025, ku teknologjia ka avancuar dhe shumë prodhues nuk hartojnë më katalogë fizik apo në formën klasike, por zgjedhin të publikojnë produktet e tyre, sëbashku me specifikimet teknike perkatesë në faqet e tyre të internetit, duke qenë se faqet e internetit tashmë janë lehtësisht më të aksesueshme nga të gjithë. Akoma më tej, faqet e internetit të kompanive prodhuese janë burime më të sigurt verifikimi se katalogët fizik, të cilët janë lehtësisht të manipulueshëm.

Në rastin konkretë, në kemi paraqitur foto nga web të produkteve në ato raste kur prodhuesi nuk disponon katalog klasik. Por nga foto, dallohet qartë produkti, prodhuesi, si dhe specifikimet teknike të produktit.

Gjithashtu, ne kemi paraqitur edhe ofertën teknike të kërkuar nga vetë AK, ku kemi shënuar në mënyrë eksplicite se ku AK mund të kryej verifikimet perkatesë për çdo produkt të preventivit. Pra, me dokumentacionin e paraqitur ne ia kemi bërë mëse të mundur autoritetit kontraktor verifikimin nga burime të pavarura prej nesh krahashimin e pajtueshmërisë e produkteve të ofruara

prej nesh me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara.

Ndërsa përsa i takon pretendimit se nuk janë të përkthyer dhe noterizuar, theksojmë se ne i kemi paraqitur të përkthyer në gjuhën shqipe, sikurse vetë AK ka kërkuar në kriterin 2.3.3. Në këtë kriter, AK në asnjë rast nuk ka kërkuar të jenë të noterizuar. Sa me sipër kërkojme nga AK dhe KPP të pranojnë ankesën, si dhe të kualifikojnë ofertën tone si të suksesshme.”

II.7. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 2653/1 prot., datë 29.09.2025, me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Ervin Luzi kundërshton me anë të ankesës me nr. 2662 prot, datë 29.09.2025.

II.8. Nëpërmjet postës elektronike është administruar shkresa e autoritetit kontraktor nr.2137 prot., datë 02.10.2025 protokolluar me tonën nr.2662/2, datë 03.10.2025 me objekt “Kthim përgjigje” nëpërmjet së cilës autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues lidhur me ankesën e tij. Referuar kësaj shkrese konstatohet se autoriteti kontraktor ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues, dhe në përfundim ka vendosur refuzimin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

II.9. Nëpërmjet shkrësës nr. 2160 prot., datë 06.10.2025, protokolluar me tonën me nr. 2662/31 prot., datë 08.10.2025 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, nga ku rezulton se ky i fundit e ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe ka vendosur mos pranimin e saj.

II.10. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të tjera të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1 Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik Ervin Luzi për shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e operatorit ekonomik e tij me arsyen se “Nuk ka paraqitur furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit ne ndriçues rrugor,

shtylla që janë zerrat me peshë me të madhe specifike ne preventive.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8, pika 2.3 “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.1 në dokumentet standarde të tenderit në procedurën e prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. *Furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit në një vlerë jo më të vogël se 20 % fondit limit prej 1,632,867 (një milion e gjashtëqind e tridhjetë e dy mijë e teteqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë, të ekzekutuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen:

- *Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e nënshkruar me entin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës.*
- *Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.*

III.1.2. Në preventivin bashkëlidhur dokumenteve standarde të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar “Blerje materiale elektrike per reabilitimin e ndricimit te aksit rrugor Shkoder - Mes” si më poshtë vijon:

Objekti: Blerje materiale elektrike per reabilitimin e ndricimit te aksit rrugor Shkoder - Mes

Nr	Emërtimi i materialit	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlefte
1	Ndriçues LED 80W, 4000 K, 10,000 lm	copë	280		
2	Panel elektrik komplet me rele korpuskulare, 3F	copë	6		
3	Shtylla metalike per ndricim H=7m, d:160mm	copë	13		
4	Kapak shtylle ndricimi 45x186mm	copë	278		
5	Minikuader shtylle ndricimi 4P, me sigures	copë	278		
6	Kabllo Cu per ndricim, te izoluar me gome, 3x2.5mm2	m	1,960		
	Shuma Pa TVSH				
	TVSH 20%				
	Shuma me TVSH				

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik

Ervin Luzi, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

- Fatura Elektronike nr.277/2024, date 03.10.2024
- Fatura Elektronike nr.197/2023, date 01.09.2023
- Fatura Elektronike nr.31/2025, date 25.03.2025
- Fatura Elektronike nr.176/2024, date 13.06.2024
- Fatura Elektronike nr.163/2024, date 06.06.2024
- Fatura Elektronike nr.267/2023, date 23.11.2023
- Fatura Elektronike nr.141/2023, date 27.06.2023
- Fatura Elektronike nr.102/2023, date 13.05.2023
- Fatura Elektronike nr.306/2023, date 28.12.2023
- Fatura Elektronike nr.88/2023, date 10.05.2023
- Fatura Elektronike nr.178/2023, date 08.08.2023
- Fatura Elektronike nr.314/2023, date 29.12.2023
- Fatura Elektronike nr.195/2023, date 28.08.2023
- Fatura Elektronike nr.200/2023, date 04.09.2023
- Fatura Elektronike nr.77/2024, date 16.04.2024
- Fatura Elektronike nr.89/2023, date 11.05.2023
- Fatura Elektronike nr.176/2024, date 13.06.2024

III.1.4.Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.1.5. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.1.6. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. *Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...*”

III.1.7. Neni 40 “Kërkesa të vecanta për kontratat e mallrave”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të

kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

III.1.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

Referuar sa më sipër, Komisioni konstaton, se në dokumentet e tenderit të procedurës objekt-ankimi, autoriteti kontraktor në lidhje me vërtetimin e përvojës së ngjashme ka kërkuar që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të paraqesin *“Furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit në një vlerë jo më të vogël se 20 % fondit limit prej 1,632,867 (një milion e gjashtëqind e tridhjetë e dy mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë, të ekzekutuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.* KPP gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të dëshmive të eksperiencës së ngjashme të dorëzuar nga ana e operatori ekonomik ankimues, parë kjo në rrafshin krahasimor me kërkesat teknike të autoritetit kontraktor, natyrës së procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Kështu, referuar dokumentit me emërtimin *“Preventiv pa cmime”* të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar mallrat objekt - prokurimi dhe sasi të respektive të tyre. KPP gjykon, se në rastin konkret, kërkesa e autoritetit kontraktor referuar objektit të procedurës së prokurimit, lidhet me furnizim vendosjen e mallrave me natyrë të tillë si ndriçues LED, panel, elektrik komplet me rele korpuskulare, shtylla metalike për ndricim, kapak shtylle ndricimi, ksblllo cu për ndricim etj në funksion të rehabilitimit të ndriçimit të aksit rrugor Shkodër- Mes.

Në nenin 77 pika 4 të ligjit nr.162/2020 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar është parashikuar se: *“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet*

kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”. KPP vlerëson se së pari, norma juridike duhet të interpretohet e më pas të gjykohej, kjo për të analizuar në thelb *ratio legis*, kuptimin e drejtë të saj. Kështu, ligjvënësi ka parashikuar diskrecionin e autoritetit kontraktor të kërimit të dëshmive për përvojën e mëparshme, me synim për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Pra, e drejta e dhënë nga ligji lidhet ngushtësisht me garantimin e autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik disponon dëshmi të përvojës së mëparshme për të realizuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar edhe më tej, ku në rastin e kontratave për mallra, ligjvënësi në nenin 40, pika 4 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ka parashikuar, se ky kriter në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me entet publike, mund të përmbushet me dorëzimin e vërtetimeve të lëshuara nga enti publik ose me paraqitjen e faturës tatimore të shitjes, ku vërtetohet realizimi me sukses i një ose disa kontratave të ngjashme gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, në një vlerë *jo më të vogël se 20 % e vlerës* së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me sektorin privat mund të përmbushet me dorëzimin e faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara, ku të vërtetohet realizimi i furnizimeve të ngjashme gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, me një vlerë *jo më të vogël se 20 % e vlerës* së kontratës që prokurohet. Gjithashtu, në rregullat e prokurimit publik është përcaktuar se plotësimi i njërit prej dy kushteve e bën ofertën të kualifikueshme.

Duke iu kthyer kriterit, KPP konstaton, se kriteri i hartuar nga ana e autoritetit kontraktor është në përputhje me diskrecionin e dhënë nga ligji dhe akti nënligjor, si edhe afati i kërimit të dokumentacionit është brenda periudhës trevjeçare sikundër parashikohet edhe në këtë Vendim të Këshillit të Ministrave.

Lidhur me faktin nëse dokumentacioni i dorëzuar nga operatori ekonomik Ervin Luzi, përmendur në pikën III.1.3. të këtij vendimi (faturat tatimore) plotësojnë apo jo kriterin kualifikues të furnizimeve të ngjashme, KPP do t'i analizojë në 3 (tre) komponentë kumulative dhe konkretisht komponenti i vlefshmërisë, komponenti i ngjashmërisë dhe komponenti i vlerës së realizuar. Për sa i përket vlefshmërisë së dokumentacionit të dorëzuar (fatura tatimore shitje të dorëzuara), Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se dokumentacioni është i vlefshëm për efekt të përmbushjes së kriterit kualifikues të sipërpërmendur dhe të përcaktuar në pikën 2.3.1 të Shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit objekt-ankimi, pra është realizuar brenda afatit 3 (tre) vjeçar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës (28.08.2025).

Lidhur me komponentin e ngjashmërisë, në analizë të thelluar dhe krahasimore të faturave tatimore të shitjes për përmbushjen me sukses të kontratës, të vlefshme, të dorëzuara nga ana e operatorit ekonomik Ervin Luzi, KPP konstaton, se me anë të faturave tatimore të dorëzuara dëshmon, se ka kryer furnizime të natyrës së shitjes së mallrave objekt – prokurimi, sikurse janë materialet elektrike për rehabilitimin e ndricimit të aksit rrugor Shkoder – Mes, KPP konstaton, se nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjitha elementeve të këtyre faturave, rezulton, se ka zëra të cilat konsiderohen të ngjashme me objektin e prokurimit, pra operatori ekonomik ka arritur që të dorëzojë dëshmi që ka realizuar furnizime të ngjashme. Sa më sipër, KPP vlerëson, se faturat tatimore të dorëzuara nga operatori ekonomik Ervin Luzi plotësojnë të tre komponentët kumulativ në interpretim të kriterit kualifikues. Në këtë kuptim, KPP gjykon, se operatori ekonomik Ervin Luzi me dokumentacionin e paraqitur, provon se ka kryer furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit, duke plotësuar kështu kërkesën për kualifikim, për përvojë të suksesshme përcaktuar në pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron

III.2. Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik Ervin Luzi për shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e operatorit ekonomik e tij me arsyen se “*Autorizimi i distributorit nga ABIESSE është për AK Bashkia Shkodër dhe jo për NSHPP. Autorizimet e prodhuesit nuk janë të perkthyer nga perkthyes të çertifikuar dhe të noterizuara*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta për kualifikim” pika 2.3 Kapaciteti teknik, pika 2.3.4 autoriteti kontraktor ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë përmbushjen e kriterit si më poshtë: *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin e kompanisë prodhuese/distributorit për shitje. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/ve si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.*

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik ankimues Ervin Luzi në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Autorizim distributori, lëshuar nga shoqëria “A BI ESSE” SHPK për z.Ervin Luzi

III.2.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*

- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.2.4. Neni 3 “Parime të përgjithshme” i ligjit nr. 162/2022 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.5. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar 6 kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund

të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.2.6. Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 3 e VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

3.Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.2.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti

kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

III.1.8. Nga shqyrtimi në tërësi i fakteve dhe rrethanave të çështjes objekt - shqyrtimi, KPP vëren se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit, ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të plotësojnë kriterin 2.3.4. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin e kompanisë prodhuese/distributorit për shitje. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/ve si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Referuar kriterit të sipërpërmendur konstatohet se autoriteti kontraktor ka përcaktuar qartë se operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar, ku të vërtetohet se është i autorizuar të tregëtojë mallrat objekt prokurimi. Në përmbushje të kriterit të sipërpërmendur, KPP konstaton se, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar dokumentacionin e përmendur në pikën III.2.2. të këtij vendimi. Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni, Komisioni konstaton se autorizimi i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues është lëshuar nga kompania A BI ESSE e cila rezulton të jetë një distributor e prodhuesit në Shqipëri. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Sa më sipër, Komisioni gjykon se me dokumentacionin e dorëzuar operatori ekonomik ankimues e plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.4 të dokumentave të tenderit.

Përsa i përket arsyes së skualifikimit të operatorit ekonomik Ervin Luzi se *Autorizimi i distributorit nga ABIESSE është për AK Bashkia Shkodër dhe jo për NSHPP* Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar dokumentin autorizim distributori dhe se pavarësisht që nga distributori është lënë autoriteti kontraktor “Drejtuar: Bashkia Shkodër”, nuk ka qënë kërkesë nga vetë autoriteti kontraktor i kësaj procedure prokurimi që autorizimi të jetë më një përmbajtje të tillë. Nisur nga kërkesa e kriterit 2.3.4. “... Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/ve si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.....”, të gjitha të dhënat e kërkuara përsaz i përket përmbajtjes së autorizimit janë lehtësisht të dukshme që janë përmbushur për nga adresa, website-i, email-i, telefoni si dhe numri i referencës së bashku me objektin. KPP, vlerëson se me dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik “Ervin Luzi është përmbushur kriteri i përcaktuar në pika 2.3.4 “Kapaciteti teknik”, të dokumentave të tenderit të procedurës objekt shqyrtimi. Pra, referuar dokumentacionit të mësipërm, si dhe, konstatohet se dokumenti “Autorizimi distributori”, rezulton se është i vlefshëm dhe në përputhje me deklaratimet e bëra nga operatori ekonomik dhe se akoma me tej i drejtohet cilit do që i intereson, dhe ndër të tjera dhe për: Bashkinë Shkodër. KPP, gjykon se pavarësisht se cilit autoritet i drejtohet autorizimin nga distributori për sa kohë autortieti

kontraktor nuk e ka kërkuar në përmbajtjen e kriterit për autorizim një formalitet të tillë dhe për sa kohë që autorizimi është sipas përmbajtjes të përcaktuar nga vetë kërkesat e autoriteti kontraktor është një kriter i përmbushur.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik Ervin Luzi për shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e operatorit ekonomik e tij me arsyen se *“Nuk keni paraqitur katalog të prodhuesit pasi kataloget e paraqitur janë marre me foto nga WEB nuk janë perkthyer e noterizuar.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.3 “Kapaciteti Teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë: Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve për mallin objekt prokurimi, në të cilat të tregohen dhe të specifikohen qarte materialit që do të ofrohet. Pjesët e katalogut të prodhuesit ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve duhet të jenë të perkthyer në shqip.

III.3.2. Në shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike” në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Shtojca 6.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët “ose ekuivalent”.

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi I Materialeve:

Përshkrimi I kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Bashkelidhur DST

III.3.3. Në shtojcën bashkëlidhur dokumenteve standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Sasia e mallit që kërkohet:

“

Objekti: Blerje materiale elektrike per rehabilitimin e ndricimit te aksit rrugor Shkoder - Mes

Nr	Emërtimi i materialit	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlefte
1	Ndriçues LED 80W, 4000 K, 10,000 lm	copë	280		
2	Panel elektrik komplet me rele korpuskulare, 3F	copë	6		
3	Shtylla metalike per ndricim H=7m, d:160mm	copë	13		
4	Kapak shtylle ndricimi 45x186mm	copë	278		
5	Minikuader shtylle ndricimi 4P, me siguresë	copë	278		
6	Kabllo Cu per ndricim, te izoluar me gothe, 3x2.5mm ²	m	1,960		
	Shuma Pa TVSH				
	TVSH 20%				
	Shuma me TVSH				

III.3.4. Në përmbushje të kriterëve më sipër operatori ekonomik “ASG” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE dokumentacionin si më poshtë:

- oferte_teknike_pdf
- Katalog për KABLLO_CU_PER_NDRICIM_plus_perkthim
- Katalog per KAPAK_SHTYLLE_KODI_9605.
- KATALOGU_DHE_PERKTHIMI_I_SPECIFIKIMEVE_PER_SHTYLLAT_KODI_991314-00
- KATALOGU_DHE_SKEDA_DISANO.
- LCIDT32M7 Specifikimet teknike shqip TeSys Deca LCDD nga Schneider Electric.

- Ndërprerës_Sigurie_A9N15646 Specifikimet teknike shqip Ndërprerës Sigurie Act9 STL.
- PERKTHIMI I KATALOGUT DISANO PER NDRICUESIN RRUGOR 80 W
- NSYCRN65250_PERKTHIMI_I_KASETES
- Skeda_A9F77416 (1)
- Skeda_A9N15646
- Skeda_CRN_NSYCRN65250
- Skeda_LC1DT32M7
- ZIPO_MINIKUADER
- ZIPO_MINIKUADER_94372P

III.3.5. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.1.6. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se

- 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.1.7. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

- 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*
 - a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
 - b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
 - c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.3.8. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrimit të mallrave.
2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.
3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.
4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat,

shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, 7 mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose
- b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose
- c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

7. Për të provuar se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që:

- a) operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- b) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi.
- c) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.
- ç) operatori ekonomik të paraqesë ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

9. Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me fondin total të përllogaritur.

III.3.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kritereve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike janë lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.3.10. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës objekt-ankimi, autoriteti kontraktor në pikën 2.3.3 ka kërkuar shprehimisht që: “Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese: Katalogun/et ose fragmente te katalogut/eve te prodhuesit/ve per mallin objekt prokurimi, ne te cilet te tregohen dhe te specifikohen qarte materiali qe do te ofrohet.Pjeset e katalogut te prodhuesit ose fragmente te katalogut/eve te prodhuesit/ve duhet te jene te perkthyer ne shqip”. Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik Ervin Luzi në sistemin e prokurimeve elektronike për përmbushjen e kriterit të mësipërm, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin e përcaktuar në pikën III.3.4. të këtij vendimi 1 oferte_teknike_pdf; 2.Katalog për KABLLO_CU_PER_NDRICIM_plus_perkthim, 3.Katalog per

KAPAK_SHTYLLE_KODI_9605;4.KATALOGU_DHE_PERKTHIMI_I_SPECIFIKIMEVE_PER_SHTYLLAT_KODI_99131400;5.KATALOGU_DHE_SKEDA_DISANO;6..LCID T32M7 Specifikimet teknike shqip TeSys Deca LCDD nga Schneider Electric; 7.Ndërprerës_Sigurie_A9N15646 Specifikimet teknike shqip Ndërprerës Sigurie Act9 STI; 8PERKTHIMI I KATALOGUT DISANO PER NDRICUESIN RRUGOR 80 W; 9.NSYCRN65250_PERKTHIMI_I_KASETES;10.Skeda_A9F77416(1);11.Skeda_A9N15646; 12.Skeda_CRN_NSYCRN65250; 13.Skeda_LC1DT32M7; 14.ZIPO_MINIKUADER; 15.ZIPO_MINIKUADER_94372P. Nisur nga arsyeja e skualifikimit dhe pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues për mospërbushjen e kriterit të parashikuar në pikën 2.3.3 përsa i përket paraqitjes së katalogëve apo skedave teknike të mjeteve të përkthyer, Komisioni pasi verifikoi dokumentacionin e ngarkuar në SPE nga ky operator ekonomik ofertues rezulton se ky ofertues ka paraqitur katalogë të produktet të kompanive prodhuese në gjuhë të huaj, por nuk ka paraqitur katalogët e përkthyer dhe të noterizuar (fakt i cili pranohet edhe vetë nga ankimuesi), ndaj kërkesa e autoritetit kontraktor me dokumentacionin e ngarkuar në SPE nga ana e operatorit ekonomik “Ervin Luzi, nuk përmbushet nga ana e këtij te fundit. Në këtë kuadër KPP gjykon, se arsyeja e skualifikimit e dhënë nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për operatin ekonomik ofertues Ervin Luzi qëndron, pasi gjuha e prokurimit është gjuha shqipe dhe katalogët e paraqitur janë në gjuhë të huaj dhe të pashoqëruar më përkthim zyrtar në gjuhën shqipe. Sa më lart, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues Ervin Luzi do të konsiderohet i parregullt, duke mosplotësuar kështu kriterin kualifikues të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.3 të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik Ervin Luzi për procedurën e prokurimit “prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-58861-08-22-2025, me objekt: “Blerje materiale elektrike per rehabilitimin e ndricimit te aksit rrugor Shkoder

- Mes'', me fond limit 8,164,336.12(Tetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e treqind e tridhjetë e gjashtë pikë dymbëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 04.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërrmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike, Shkodër

2. Autoriteti Kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit për operatorin ekonomikë ankimes sipas konstatimeve të këtij vendimi.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar operatori ekonomik të paguar nga operatori ekonomik Ervin Luzi.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiovent Zguro

